



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.71/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjekteve politike Gragjanska Iniciativa Srpska Lista dhe Progresivna Demokratska Stranka (PDS), me seli në Graçanicë, për shkak të vendosjes së posterave në shtyllë publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Gragjanska Iniciativa Srpska Lista, me seli në Graçanicë dhe subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS), me seli në Graçanicë ju shqiptohen dënimet me gjobë, secili nga 1,300.00 (njëmijë e treqind) euro.

II. Subjektet politik Lista Serbe dhe Progresivna Demokratska Stranka (PDS), **detyrohen** ti paguajnë gjobat e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbarimit.**

A r s y e t i m

Me datën 05.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017 në rrugën kryesore në qytezën e Graçanicës në rrugën Petar Lazër, monitoruesi i tyre ka hasur ne poster të subjekteve politike Gragjanska Iniciativa Srpska Lista si dhe të subjektit politik Progresivna Demokratska Stranka (PDS) të ngjitura në hapësirë publike, përkatësisht në shtyllë publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017, subjekti politik GI Lista Srpska, thekson se subjekti i tyre politik e respekteton Ligjin nr.03/L-073, Rregulloren Zgjedhore nr.11/2013 dhe

sipas kësaj të gjithë aktivistët e saj i ka njoftuar qartë me udhëzimet se në çfarë mënyre dhe ku lejohet të ekspozohen posteret politike gjatë fushatës zgjedhore. SP-GISL në përgjigjen në ankesë ka theksuar se do të zhvillojë një procedurë të hetimit dhe vërtetimit nëse dikush nga aktivistët, sipas gjitha gjasave për shkak mos dijes, ka vendosur postere në vendet ku nuk lejohet vendosja e tyre, me çka është evituar parregullësia e vërejtur.

Duke marr parasysh faktin se Srpska Lista ka ndërmarr masat korrektuese dhe i ka evituar parregullsitë, si dhe shkelja e pretenduar nuk është bërë qëllimisht por pa dashje, kanë kërkuar që të pranohet kërkesa tyre dhe që mos të shqiptohen gjobat apo sanksione tjera ndaj SP GI Srpska Lista.

Si dëshmi përgjigjes në ankesë u janë bashkangjitur fotografitë nga terreni pas ndërmarrjes së masave korrektuese nga ana e SP GI Srpska Lista

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017, e ofruar nga PDS-ja mund të shihet se PDS me një njoftim zyrtar i ka njoftuar anëtarët, simpatizantët dhe kandidatët e vetë me Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatet e tyre. Në këtë njoftim i cili është protokolluar me nr.25/2017 të datës 24.05.2017 në librin e protokollit të PDS-së theksohen dhe parashihen të gjitha veprimet e ndaluara për anëtarët, simpatizantët dhe kandidatët e PDS-së gjatë procesit zgjedhor.

Në fund të njoftimit theksohet se PDS-ja publikisht dhe seriozisht i gjykon anëtarët, simpatizantët dhe kandidatët e saj për çdo shkelje të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes dhe rregullave në fuqi që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Si dëshmi janë bashkangjitur edhe dy fotografi nga vendi i ngjarjes ku shihet se janë ndërmarr masat korrektuese për evitimin e shkeljes së bërë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët subjekteve politike GI Srpska Lista dhe PDS janë vendosur në shtyllë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në objekte dhe në rrugë publike.*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e subjekteve politike Gradanska Iniciativa Serpska Lista (GISL) dhe Progresivna Demokratska Stranka (PDS), është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), pasi që posterat e subjekteve politike GISL dhe PDS janë vendosur në shtyllë publike. Të cilën shkelje e kanë pranuar edhe vetë subjektet politike GISL dhe PDS, në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike GISL dhe PDS kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore dhe për kundër këtij fakti posterat e subjekteve politike GISL dhe PDS janë vendosur në shtyllë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori parasysh edhe faktin se subjekteve politike në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur sipas kërkesës për përgjigje në ankesë dhe Urdhërit për ndërrmarjen e masave korrektuese, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 i LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.71/2017 më datën 07.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Zynderi Haziri



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.